



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 73, datë 7.2.2018

PËR

**MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE TË MENAXHIMIT
TË INTEGRUAR TË BURIMEVE UJORE, 2018-2027**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të shkronjës “b”, të pikës 4, të nenit 8, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore, 2018-2027, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen organet përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe të gjitha institucionet e përmendura në tekstin e kësaj strategjie për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTRI I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL

NIKO PELESHI

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDESMINISTRI

ERMIRA GJEÇI